# ABI INVEST SHA

Pasqyrat Financiare për periudhen e mbyllur më
30 Qershor 2023
(të pa-audituara)

# PËRMBLEDHJE


**PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR** 1

**PASQYRA E FITIM HUMBJEVE DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE** 3

**PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL** 4

**PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE** 5

1. HYRJE 7

2. BAZA E PERGATITJES 7

3. POLITIKAT KONTABEL 9

4. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR 10

5. PARAQITJA DHE VLERESIMI I VLERES SE DREJTE 11

7. MJETET MONETARE DHE TE NGJASHME 12

9. KAPITALI AKSIONAR 12

10. DETYRIME TË TJERA 12

11. SHPENZIMET E PERSONELIT 13

12. SHPENZIME ADMINISTRATIVE 13

13. SHPENZIME FINANCIARE 13

| **Informacioni** | **Përshkrimi, vlera** |
|---|---|
| Kodi i shoqërisë së administrimit | L92424002L |
| Numri i regjistrimit në QKR | |
| Numri për raportimin | 2023-2 |
| Adresa | Tirane Tirane TIRANE Rruga e Kavajës, Ndërtesa nr 27, Hyrja 1, kati 2, Njësia bashkiake 10, Kodi Postar 1001 |
| Telefon dhe fax | +355 44537189 |
| Email: | info@abinvest.al |
| Faqe web | www.abinvest.al |
| Data e licencimit | 27.02.2020 |
| Emri dhe mbiemri i Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit Administrativ | 1. Armand Muharremi (kryetar)<br>2. Teuta Cinari (zv. kryetare)<br>3. Brikena Hoxha<br>4. Redi Hakani<br>5. Niko Kotonika |
| Pesë aksionarët më të mëdhenj (emri, mbiemri, adresa ose emri i shoqërisë dhe adresa e zyrtare, përqindja e aksioneve në pronësi) | Banka Amerikane e Investimeve 100% |
| Shoqëria e ekspertit kontabël që ka audituar e fundit pasqyrat financiare | Grant Thornton |
| Banka (depozitari) me të cilin kryen veprimet shoqëria e administrimit | Banka Credins Sha<br>Banka e Pare e Investimeve |
| Numrat e llogarise | |
| **Llogarite e shoqerise administruese** | |
| Banka Credins | AL85212115730000000001473370 |
| Banka Amerikane e Investimeve | AL69210110120000000002245839 |
| Banka Amerikane e Investimeve | AL19210110120000000002414549 |
| Banka e Pare e Investimeve | AL2721511031EUR1000016354800 |
| Banka e Pare e Investimeve | AL5321511031USD1000016354800 |
| **Llogarite e fondit te investimit ABI EIA** | |
| Banka Credins | AL79212115730000000001473478 |
| **Llogarite e fondit te investimit ABI Flex EURO** | |
| Banka e Pare e Investimeve | AL1321511031EUR1000016130400 |
| **Llogarite e fondit te investimit ABI Flex USD** | |
| Banka e Pare e Investimeve | AL0721511031USD1000016130200 |

## PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

**më 30 Qershor 2023**

| AKTIVI | Lekë 31/12/2022 | Lekë 30/06/2023 |
|---|---|---|
| **A. Aktive afatgjata (I+II+III)** | **4,891,960** | **3,770,751** |
| I. Aktive të paqëndrueshme | 4,891,960 | 3,770,751 |
| II. Aktive të qëndrueshme | - | - |
| III. Aktive financiare (1+2) | - | - |
| 1. Depozita bankare | | |
| 2. Aktive të tjera dhe debitorë afatgjatë | | |
| **B. Aktive afatshkurtra (I+II+III+IV)** | **23,838,162** | **23,933,819** |
| I. Pajisje në magazinë, inventar i imët dhe pajisje të tjera | | |
| II. Debitorë(1+2+3+4) | 1,082,635 | 814,622 |
| 1. Debitorë nga sipërmarrjet kolektive | | |
| 2. Debitorë nga sasitë e paguara tepër prej fitimit | | |
| 3. Debitorë nga shteti dhe institucione të tjera | | |
| 4. Debitor të tjerë | 1,082,635 | 814,622 |
| III. Aktive financiare (1+2+3+4) | 19,753,629 | 19,609,105 |
| 1. Depozita bankare | | |
| 2. Aktive të tjera dhe debitorë afatshkurtër | | |
| 3. Kuota në fonde investimi | | |
| 4. Të tjera aktive financiare | 19,753,629 | 19,609,105 |
| IV. Mjete monetare në bankë dhe arkë (1+2) | 3,001,898 | 3,510,092 |
| 1. Mjete monetare në bankë | 3,001,898 | 3,510,092 |
| 2. Mjete monetare në arkë | | |
| C. Shpenzime të parapaguara | - | - |
| D. Të ardhura të marra në avancë | - | - |
| E. Aktive (A+B+C+D) | 28,730,122 | 27,704,570 |
| F. Zëra jashtë bilancit | | |
| **TOTAL (E+F)** | **28,730,122** | **27,704,570** |

| PASIVI | Lekë 31/12/2022 | Lekë 30/06/2023 |
|---|---|---|
| A. Kapitali (I+II+III+IV+V+VI) | 28,124,686 | 26,993,981 |
| **I. Kapitali i nënshkruar** | **45,000,000** | **45,000,000** |
| II. Prime për aksione të emetuara | | |
| III. Rezerva e rivlerësimit | (154,866) | 66,100 |
| IV. Rezerva të tjera | | |
| V. Fitime (humbje) të mbartura | (13,950,656) | (16,720,447) |
| VI. Fitimi (humbja) e periudhës financiare | (2,769,792) | (1,351,678) |
| B. Detyrime afatgjata (I+II) | - | - |
| I. Detyrime ndaj sipërmarrjeve të investimit | | |
| II. Përgjegjësi të tjera afatgjata | | |
| C. Përgjegjësi afatshkurtra (I+II+III) | 605,436 | 710,589 |
| I. Detyrime sipërmarrjeve te investimit | | |
| II. Detyrime të lidhura me hua dhe kredi | | |
| III. Detyrime të tjera afatshkurtra | 605,436 | 710,589 |
| D. Shpenzime të shtyra | | |
| E. Të ardhura të marra në avancë | | |
| F. Kapitali dhe detyrimet (A+B+C+D+E) | 28,730,122 | 27,704,570 |
| G. Zëra jashtë bilancit | | |
| TOTAL (F+G) | **28,730,122** | **27,704,570** |

Shënimet shpjeguese të paraqitura në faqet 5 deri në 12 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

## PASQYRA E FITIM HUMBJEVE DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE

**për periudhen e mbyllur më 30 Qershor 2023**

| | Lekë<br>30/06/2022 | Lekë<br>30/06/2023 |
|---|---|---|
| **I. Të ardhura nga administrimi - (1+2+3)** | **3,981,676** | **5,059,125** |
| 1. Tarifa të administrimit | 3,981,676 | 5,059,125 |
| 2. Tarifa të largimit nga fondi | | |
| 3. Tarifa të tjera | - | - |
| **II. Shpenzime nga administrimi (1+2+3+4)** | **(293,064)** | **(5,000)** |
| 1. Shpenzime të transaksioneve | | |
| 2. Shpenzime të marketingut | | |
| 3. Shpenzime të shitjes me agjent | | |
| 4. Shpenzime të tjera të administrimit | (293,064) | (5,000) |
| **III. Fitim / Humbja nga administrimi (+/-) (I - II)** | **3,688,611** | **5,054,125** |
| **IV. Të ardhura të tjera** | **-** | **-** |
| **V. Shpenzime të veprimtarisë së shoqërisë administruese (1+2+3+4+5+6)** | **(5,953,914)** | **(6,393,931)** |
| 1. Shpenzime materiale | | |
| 2. Shpenzime të personelit | (3,188,979) | (3,720,495) |
| 3. Amortizim i aktiveve material/jomateriale afatgjata | (1,121,209) | (1,121,209) |
| 4. Rregullim i vlerës së aseteve afatshkurtra | | |
| 5. Provigjone për shpenzime dhe rreziqe | | |
| 6. Shpenzime të tjera të veprimtarisë | (1,643,726) | (1,552,227) |
| **VI. Të ardhura/Shpenzime financiare** | **62,540** | **(11,872)** |
| **VII. Shpenzime financiare** | **-** | **-** |
| **VIII. Fitim / Humbja nga veprimtaria (+/-) (III+IV-V+VI-VII)** | **(2,202,763)** | **(1,351,678)** |
| **IX. Të ardhura të jashtëzakonshme** | **-** | **-** |
| **X. Shpenzime të kontingjencës** | **-** | **-** |
| **XI. Fitim / Humbja e periudhës financiare para tatimit (VIII+IX-X)** | **(2,202,763)** | **(1,351,678)** |
| **XII. Tatimi mbi fitimin** | **-** | **-** |
| **XIII. Fitim / Humbja pas tatimit (XI-XII)** | **(2,202,763)** | **(1,351,678)** |

Shënimet shpjeguese të paraqitura në faqet 6 deri në 13 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë nënshkruar në emër të Shoqërisë më 14 Korrik 2023 nga:

____________________________

Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv
Niko Kotonika

## PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

**për vitin e mbyllur më 30 Qershor 2023**

| | Lekë<br>31/12/2022 | Lekë<br>Rritje | Lekë<br>Zbritje | Lekë<br>30/06/2023 |
|---|---|---|---|---|
| I. Kapitali i nënshkruar | 45,000,000 | - | - | 45,000,000 |
| II. Prime për aksione të emetuara | | | | |
| III. Rezerva e rivlerësimit | (154,866) | 66,106 | (154,866) | 66,106 |
| IV. Rezerva të tjera | | | | |
| V. Fitime (humbje) të mbartura | (16,720,447) | - | - | (16,720,447) |
| VI. Fitimi (humbja) e periudhës ushtrimore | - | (1,351,678) | - | (1,351,678) |
| VII. Pagesat e dividendit | | | | |
| VIII. Ndryshime në politikat kontabël dhe korrigjime | | | | |
| IX: Ndryshime të tjera në kapital | | | | |
| **TOTALI I KAPITALIT (I+II+III+IV+V+VI+VII+VIII+IX)** | **28,124,687** | **(1,285,572)** | **(154,866)** | **26,993,981** |

Shënimet shpjeguese të paraqitura në faqet 6 deri në 13 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

## PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE

**për periudhën e mbyllur më 30 Qershor 2023**

| | Lekë<br>31/12/2022 | Lekë<br>30/06/2023 |
|---|---|---|
| a. Hyrje nga veprimtaria e shoqërisë | 39,718,428 | 30,929,254 |
| b. Dalje nga veprimtaria e shoqërisë | 38,259,656 | 30,421,061 |
| **c. Fluksi neto i parave nga veprimtaria e shoqërisë (a - b)** | **1,458,772** | **508,193** |
| d. Hyrje nga veprimtaria e investimeve | - | - |
| e. Dalje nga veprimtaria e investimeve | - | - |
| **f. Fluksi neto i parave nga veprimtaria e investimeve (d - e)** | **-** | **-** |
| g. Hyrje nga veprimtaria financuese | - | - |
| h. Dalje nga veprimtaria financuese | - | - |
| **i. Fluksi neto i parave nga veprimtaria financuese (g - h)** | **-** | **-** |
| **j. Fluksi neto - rritje (zvogëlim) (c+f+i)** | **1,458,772** | **508,193** |
| k. Gjendja në fillim të periudhës | 1,543,127 | 3,001,898 |
| **l. Gjendja në fund të periudhës** | **3,001,898** | **3,510,092** |

**Pasqyra e detajimit te tarifave**

| Emertimi i Fondit | Lloji i Fondit | Tarifa e Administrimit |
|---|---|---|
| ABI EIA | Fond Investimi | 1,644,652.80 |
| ABI FLEX EURO | Fond Investimi | 2,912,926.86 |
| ABI FLEX USD | Fond Investimi | 501,544.97 |

**Pasqyra e strukturës së investimeve**

| Pozicioni | Referenca | Maturiteti | Vlera në momentin e depozitimit | Vlera në datën e raportimit |
|---|---|---|---|---|
| Depozita nën 3muaj | | | | |
| Llogari rrjedhëse | | <= 3 Muaj | 3,510,092.00 | 3,510,092.00 |
| **Totali I Mjeteve dhe Depozitave** | | | | |

Shënimet shpjeguese të paraqitura në faqet 6 deri në 13 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Pasqyra e strukturës së investimeve**

| POZICIONI | ISIN | MATURITETI | VLERA NOMINALE | VLERA E BLERJES | VLERA NE DATEN E RAPORTIMIT |
|---|---|---|---|---|---|
| Bono të thesarit vendase | AL000A3LDQZ7 | 12 muaj | 20,000,000 | 19,665,175 | 19,609,105 |
| Emetime të bankës qendrore vendase | | | | | |
| Dëftesa tregtare vendase | | | | | |
| Kuota në fonde vendase | | | | | |
| Letra me të tjera me vlerë vendase | | | | | |
| **TOTALI I LETRAVE TE TJERA ME VLERE TE EMETUESVE VENDAS** | AL000A3LDQZ7 | 12 muaj | 20,000,000 | 19,665,175 | 19,609,105 |
| Bono të thesarit të huaja | | | | | |
| Emetime të bankës qendrore të huaja | | | | | |
| Dëftesa tregtare të huaja | | | | | |
| **TOTALI I LETRAVE TË TJERA ME VLERË TË EMETUESVE TE HUAJ** | | | | | |

## 1. HYRJE

ABI INVEST sh.a eshte nje Institucion Financiar i regjistruar si Shoqeri Administruese e Sipermarrjeve te Investimeve Kolektive bazuar ne ligjin 10198, date 10.12.2009.

Me 20 Qershor 2020 ka hyre ne fuqi Ligji 56/2020, date 30.04.2020 “Per Sipermarrjet e Investimeve Kolektive” i cili ka shfuqizuar Ligjin 10198, date 10.12.2009.

Aktiviteti i shoqerise i nenshtrohet Ligji 56/2020, date 30.04.2020 “Per Sipermarrjet e Investimeve Kolektive”, Ligjit nr.9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqëritë tregtare”, si dhe eshte ne perputhje me te gjitha aktet nen-ligjore te aprovuara nga Autoriteti i Mbikeqyrjes Financiare dhe me legjislacionin tjeter ne fuqi.

Shoqeria eshte regjistuar si shoqeri aksionare ne Qendren Kombetare te Biznesit me numer regjistrimi (NUIS) L92424002L me 24 dhjetor 2019 dhe eshte licencuar nga Autoriteti i Mbikeqyrjes Financiare me date 27.02.2020.

Shoqeria zoterohet 100% nga Banka Amerikane e Investimeve sh.a. (“Mëma”)

Selia Qendrore e shoqërisë ABI INVEST sha eshte: Rruga e Kavajes, Ndertesa nr.27, Hyrja 1. Kati II, Njesia Bashkiake 10, Kodi Postar 1001.

Shoqeria ABI Invest sha funksionon si shoqeri aksionare e cila administrohet nga një ose më shumë administratorë.

**Drejtuesit dhe administrimi i shoqërisë me 30 Qershor 2023:**

*Keshilli i Administrimit*

| | |
|---|---|
| Kryetar | - Armand Muharremi |
| Anetar | - Niko Kotonika |
| Zv/Kryetar | - Teuta Lloshi |
| Anetar | - Brikena Hoxha |
| Anetar | - Redi Hakani |

Administrator – Niko Kotonika

## 2. BAZA E PERGATITJES

### 2.1 Deklarata e perputhshmerise

Pasqyrat financiare te Shoqerise jane pergatitur ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar (“SNRF”) te nxjerra nga Bordi i Standardeve Nderkombetare te Kontabilitetit (“BSNK”).

### 2.2 Baza e pergatitjes

Pasqyrat financiare te Shoqerise jane pergatitur mbi bazen e kostos historike me perjashtim te Investimeve ne letra me vlere te cilat maten me vleren e drejte nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

### 2.3 Periudhat krahasimore

Shoqëria eshte regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit me 24 Dhjetor 2019 ndaj ne keto pasqyra financiare te pergatitura nga shoqeria nuk kane një periudhë të mëparshme krahasimore. Shoqeria nuk ka pasur aktivitet gjate vitit 2019 pasi nuk ka qene e licencuar.

### 2.4 Monedha funksionale dhe ajo e prezantimit

Keto pasqyra financiare te Shoqerise jane paraqitur ne Lek Shqiptar (Leke), e cila eshte monedha funksionale e Shoqerise.

### 2.5 Parimi i vijimësisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e vijimësisë. Kapitali i përgjithshëm i shoqerise nuk është në vlera negative. Pasqyrat financiare nuk përfshijnë rregullimet që do të rezultonin në qoftë se kompania nuk do të ishte në kushtet e aktivitetit në vijimësi. Në bazë të ligjit "Për procedurat tatimore", administrata tatimore ka të drejtë të fillojë proçesin e likuidimit për ato kompani të cilat rezultojnë me total kapitali negativ për një periudhë prej të paktën tre vjet rresht.

### 2.6 Perdorimi i vleresimeve dhe gjykimeve

Pergatitja e pasqyrave financiare ne perputhje me SNRF-te kerkon qe Drejtimi te beje gjykime, vleresime dhe supozime te cilat ndikojne ne aplikimin e politikave kontabel dhe vlerave te raportuara te aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund te ndryshojne nga keto vleresime.

Vleresimet dhe supozimet baze rishikohen vazhdimisht. Rishikimet ndaj vleresimeve kontabel njihen ne periudhen ne te cilen ndodh rishikimi dhe ne periudhat e ardhshme qe afektohen/preken nga keto ndryshime. Drejtimi beson se vleresimet dhe supozimet baze jane te duhura dhe se, si rrjedhoje, pasqyrat financiare paraqesin sakte pozicionin dhe rezultatin financiar. Ne veçanti, informacionet mbi fushat me te rendesishme te vleresimeve dhe gjykimeve ne aplikimin e politikave kontabel te cilat kane efektet me te rendesishme ne shumat e njohura ne pasqyrat financiare, jane pershkruar ne shenimet perkatese te pasqyrave financiare.

**BAZA E PERGATITJES (VAZHDIM)**

### 2.7 Zbatimi i ndryshimeve në Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

Standarde të miratuara që kanë hyrë në fuqi:

#### i. SNRF 9 Instrumentat Financiare

SNRF 9 zevendeson SNK 39 per periudhat vjetore qe fillojne ne dhe pas 1 janar 2018.

**Klasifikimi dhe matja**

Kategorite e matjes se aktiveve financiare sipas SNRF 9 jane si me poshte:

- Instrumentet e borxhit me konston e amortizuar;
- Instrumentet e borxhit me vlere te drejte permes te ardhurave te tjera permbledhese (VDAGJ), me fitime ose humbje te riciklueshme ne fitim ose humbje gjate çregjistrimit;
- Instrumentet e kapitalit ne VDAGJ, pa riciklimin e fitimeve ose humbjeve, ose fitim ose humbje gjate çregjistrimit;
- Aktivet financiare me vlere te drejte ne fitim humbje.

Kontabilizimi i detyrimeve financiare mbetet kryesisht i njejte me ate te SNK 39, perveç trajtimit te fitimeve ose humbjeve qe lindin nga rreziku i kredise te nje njesie ekonomike qe lidhet me detyrimet e percaktuara ne VDAGJ, te cilat duhet te paraqiten permes te ardhurave te tjera permbledhese pa riklasifikim te mevonshem ne fitim ose humbje.

**Metoda e perllogaritjes së zhvleresimit**

SNRF 9 kerkon qe Shoqeria te regjistroje nje fond zhvleresimi per ECL-te per te gjitha aktivet financiare qe nuk mbahen me vlere te drejte ne fitim humbje, se bashku me angazhimet e huase dhe kontratat e garancive financiare. Fondi i zhvleresimit bazohet ne humbjet e pritshme qe lidhen me probabilitetin e deshtimit ne dymbedhjete muajt e ardhshem nese nuk ka pasur nje rritje te konsiderueshme ne rrezikun e kredise qe nga krijimi i saj. Nese aktivi financiar ploteson perkufizimin e instrumetit financiar se blere ose te origjinuar te zhvleresuar (“POCI”), fondi i zhvleresimit bazohet ne ndryshimin e ECL-ve gjate jetes se aktivit.

Detajet e metodes se zhvleresimit te Shoqerise jane shpalosur ne Shenimin 3.5.3

#### ii. SNRF 15 Të ardhurat nga Kontratat me Klientët

Standardet dhe amendimet e reja të paraqitura janë të zbatueshme për periudhat financiare që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2018. Të dyja këto standarde janë të zbatueshme për shoqërinë por nuk kanë efekt dhe nuk nevojitet riparaqitje pasi elementet e Pasqyrave Financiare të vitit 2018 që preken nga këto ndryshime ose nuk ekzistojnë ose diferencat e vlerësuara janë jomateriale. Shënimet lidhur me politikat kontabël të përdorura në këto gjykime jepen në vijim.

### 2.8 Standarde dhe interpretime të publikuara që nuk janë ende të aplikueshme

#### 2.8.1 SNRF 16 Qiraja

Ky standard dhe amendimet e reja të paraqitura janë të zbatueshme për periudhat financiare që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2019 e në vijim. Më 30 Qershor 2023, Shoqeria nuk ka asnje qera ndaj edhe aplikimi i ketij standardi nuk ka efekt per periudhen me 30 Qeshor 2023.

## 3. POLITIKAT KONTABEL

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente nga Shoqëria, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

### 3.1 Transaksionet ne monedhe te huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jomonetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit, ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

## 3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

### 3.2 Interesat

Sipas SNRF 9, te ardhurat nga interesat regjistrohen duke perdorur metoden e normes efektive te interest (“NEI”) per te gjithe instrumentet financiare te matur me koston e amortizuar, instrumentet financiare te dizenjuar me Vlere te Drejte ne te ardhurat te tjera gjithperfshirese (“FVOCI”).

Norma efektive e interesit eshte norma, me te cilen skontohen ekzaktesisht pagesat e vleresuara te ardhshme te mjeteve monetare ose arketimet pergjate jetes se pritshme te instrumentit financiar (ose kur eshte e pershtatshme, per periudhen me te shkurter), duke arritur ne vleren kontabel neto te aktivit financiar.

Kur nje aktiv financiar zhvleresohet dhe per kete arsye quhet si ne “Klasa 3”, Shoqeria i perllogarit te ardhurat nga interesat duke aplikuar normen efektive te interesit mbi vleren neto te aktivit financiar. Nese aktivi financiar permiresohet dhe nuk eshte me i zhvleresuar, Banka e kthen menyren e perllogaritjes se te ardhurave nga interesi mbi vlerat bruto te tij. Shoqeria nuk ka aktive financiare te zhvleresuara ose ne te klasifikuara ne “Klasa 3”.

### 3.3 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin njihet ne pasqyren e fitim humbjeve te periudhes me perjashtim te rasteve qe lidhen me zera qe njihen direkt ne kapital ose ne te ardhura te tjera permbledhese.

### 3.5.3. Perllogaritja e ECL-ve (vazhdim)

Mekanika e metodes ECL eshte permbledhur me poshte:

- Klasa 1: 12muaj ECL llogaritet si pjese humbes se pritshme te aktiveve financiare qe perfaqesojne ECL-te qe rezultojne nga ngjarjet e deshtimit te nje instrumenti financiar qe jane te mundshme brenda 12 muajve pas dates se raportimit. Shoqeria llogarit fondin e 12muaj ECL bazuar ne pritshmerine e nje mospagimi qe ndodh ne 12 muajt pas dates se raportimit. Keto probabilitete te deshtimit te pritur 12-mujor aplikohen mbi nje EAD te parashikuar dhe shumezohen me LGD-ne e pritshme.
- Klasa 2: Kur nje instrument financiar ka shfaqur nje rritje te konsiderueshme te rrezikut te kredise qe nga krijimi i saj, Shoqeria regjistron nje fond per humbjen e pritshme. Mekanika eshte e ngjashme me ato te shpjeguara me siper, por PD-te dhe LGD-te vleresohen gjate gjithe jetes se instrumentit. Mungesat e arketimeve te pritura te parave skontohen me NEI origjinale. Shoqeria nuk ka aktive financiare te klasifikuara ne Klasen 2.
- Klasa 3: Per instrumentat financiar qe konsiderohen si te zhvleresuara, Shoqeria njeh humbje te pritshme. Metoda eshte e ngjashme me ate per aktivet e Klases 2, me PD te vendosur ne 100%. Shoqeria nuk ka aktive financiare te klasifikuara ne Klasen 3.

POCI: Aktivet POCI jane aktive financiare qe jane te zhvleresuara qe ne njohjen fillestare. Shoqeria njeh vetem ndryshimet kumulative ne LTECL-te qe nga njohja fillestare, skontuar nga NEI e rregulluar. Shoqeria nuk ka aktive financiare POCI.

### 3.3.1 Matja e vleres se drejte

‘Vlera e drejte’ eshte çmimi me te cilin aktivi mund te shitet, ose nje detyrim te transferohet, ne nje transaksion te zakonshem mes pjesemarresve ne treg ne daten e matjes, ne nje treg primar ose ne mungese te tij, ne tregun me te favorshem ne te cilin Shoqeria ka akses ne ate date.

Per te treguar se si jane nxjerre vlerat e drejta, instrumentet financiare jane riklasifikuar bazuar ne nje hierarki te teknikave te vleresimit, siç permblidhet me poshte:

- Niveli 1: Ato ku inputet e perdorura ne vleresim jane çmimet e kuotuara te parregulluara ne tregjet aktive per nje instrument identik ne te cilat Shoqeria ka qasje ne daten e matjes.

- Niveli 2: Kjo kategori perfshin instrumente te vleresuara duke perdorur: çmimet e kuotuara te tregut ne tregjet aktive per instrumente te ngjashme; çmimet e kuotuara per instrumente te ngjashme ne tregje qe konsiderohen me pak se

### 3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

aktive; ose teknika te tjera vleresimi ku te gjithe inputet e rendesishme jane direkt ose indirekt te vezhgueshme nga te dhenat e tregut.

- Niveli 3: Kjo kategori perfshin gjithe instrumentet ku teknikat e vleresimi perfshijne inpute te cilat nuk bazohen ne te dhena te vezhgueshme dhe inputet e pavezhgueshme mund te kete nje efekt te rendesishem ne vleresimin e instrumentit. Kjo kategori perfshin instrumente qe jane vleresuar ne baze te çmimeve te kuotuara per instrumente te ngjashme, ku rregullime te rendesishme te pavezhgueshme ose supozime jane te nevojshme per te reflektuar diferencat midis instrumenteve

#### 3.3.2 Mjetet monetare dhe ekuivalentet e saj

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e saj perfshijne llogari rrjedhese ne banke likuide me maturim fillestar deri ne tre muaj te cilat, kane rrezik te pakonsiderueshem ndryshimi te vleres se tyre te drejte, dhe perdoren nga Shoqeria per manaxhimin e angazhimeve afatshkurtra.

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e saj mbahen me kosto te amortizuar ne pasqyren e vecante te pozicionit financiar

#### 3.3.3 Perfitimet e punonjesve

***Planet e percaktuara te kontributeve***

Detyrimet per kontributet per planet e percaktuara te pensioneve njihen si nje shpenzim ne fitim ose humbje kur ato ndodhin. Shoqeria paguan kontribute te detyrueshme per sigurimet shoqerore per perfitimet e punonjesve qe dalin ne pension. Autoritetet lokale jane pergjegjese per percaktimin e limitit minimal ligjor te vendosur per pensionet ne Shqiperi sipas nje plani kontributesh pensioni te percaktuar.

***Perfitimet afatshkurtra***

Detyrimet afatshkurtra per perfitimet e punonjesve maten ne nje baze te paskontuar dhe njihen si shpenzime kur ofrohet sherbimi. Nje provigjon eshte njohur per shumen qe pritet te paguhet si bonus afatshkurter ne para ose planeve me ndarje fitimi nese Shoqeria ka nje detyrim ligjor ose konstruktiv per te paguar kete shume si rezultat i sherbimeve te shkuara te ofruara nga punonjesi, dhe detyrimi mund te matet me besueshmeri.

## 4. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR

*(a) Rreziku i Likuiditetit*

Rreziku i likuiditetit përcaktohet si rreziku që një njësi ekonomike do të përballet me vështirësi për të përmbushur detyrimet që lidhen me pasivet financiare. Shoqëria është e ekspozuar ndaj nevojave të përditshme për burime monetare, kryesisht për të shlyer detyrimet e krijuara gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj normal. Drejtimi monitoron në mënyrë të vazhdueshme këtë risk duke bërë parashikime për flukset e parave.

Tabela e mëposhtme paraqet një analizë të aktiveve dhe detyrimeve financiare të shoqërisë më 30 Qershor 2023 sipas maturitetit të mbetur duke marrë në konsideratë fluksin e parave të paskontuara sipas maturitetit kontraktual dhe duke reflektuar supozime për ri-pagesa të hershme apo duke përdorur të dhënat historike.

| **30 Qershor 2023** | **Me pak se 6 muaj** | **Midis 6 dhe 12 muaj** | **Me shume se 1 vit** | **Totali** |
|---|---|---|---|---|
| Mjete Monetare | 3,510,092 | - | | 3,510,092 |
| Të tjera aktive financiare VDATGJ (BTH të Qeverisë Shqiptare) | | 19,609,105 | | 19,609,105 |
| Aktive te tjera | 814,622 | - | - | 814,622 |
| **Totali** | **4,324,714** | **19,609,105** | **-** | **23,933,819** |
| | | | | |
| Detyrime të tjera | 710,589 | - | - | 710,589 |
| **Totali** | **710,589** | **-** | **-** | **710,589** |
| | | | | |
| **Hendeku i likuiditetit me 30.06.2023** | **3,614,125** | **19,609,105** | **-** | **23,223,230** |
| **Kumulativ** | **3,614,125** | **23,223,230** | **23,223,230** | **-** |

## 5. PARAQITJA DHE VLERESIMI I VLERES SE DREJTE

Vleresimet e vleres se drejte jane bazuar mbi instrumentat financiare ekzistuese ne bilanc pa tentuar te vleresohet vlera e paraprire e biznesit te ardhshem dhe vleren e aktiveve dhe detyrimeve qe nuk konsiderohen si instrument financiar.

Tabela e meposhtme tregon vleren e drejte te instrumentave financiare dhe analizon ato nga hierarkia e vleres se drejte ne te cilen eshte klasifikuar çdo vlere e drejte.

| | Me 30 Qershor 2023 | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Vlera e mbartur | Vlera e drejte Niveli 1 | Vlera e drejte Niveli 2 | Vlera e drejte Niveli 3 |
| **Aktive financiare** | | | | |
| Mjete Monetare | 3,510,092 | - | - | 3,510,092 |
| Të tjera aktive financiare VDATGJ (BTH të Qeverisë Shqiptare) | 19,609,105 | | 19,609,105 | |
| Aktive te tjera | 814,622 | - | - | 814,622 |
| **Detyrime financiare** | | | | |
| Detyrime të tjera | 710,589 | - | - | 710,589 |

*Mjete monetare dhe ekuivalente*

Mjete monetare dhe ekuivalente perfshijne llogari rrjedhe me Bankat, vlera e tyre e drejte konsiderohet te jete e njejte me vleren kontabel te tyre.

*Detyrime te tjera*

Detyrime te tjera perfshijne perllogaritje te pagueshme dhe vlera e tyre e drejte konsiderohet te jete e njejte me vleren kontabel te tyre

## 6. AKTIVE AFATGJATA JOMATERIALE

| | Programe kompjuterike |
|---|---|
| **Kosto** | |
| **Gjëndja më 1 janar 2023** | **8,920,115** |
| Shtesa | - |
| Transferime | - |
| **Gjëndja më 30 Qershor 2023** | **8,920,115** |
| **Amortizimi akumuluar** | |
| **Gjëndja më 1 janar 2023** | **(4,028,154)** |
| Shpenzimi i periudhes | (1,121,210) |
| Pakësime | - |
| **Gjëndja më 30 Qershor 2023** | **(5,149,364)** |
| **Vlera kontabël neto** | |
| **Më 30 Qeshor 2023** | **3,770,751** |

## 7. MJETET MONETARE DHE TE NGJASHME

Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to mbahen në llogari të ABI Bank, Banken e Pare të Investimeve dhe Credins Bank dhe për 30 Qershor 2023 janë si më poshtë:

| | 30 Qershor 2023 |
|---|---:|
| Llogari rrjedhëse me Banken Credins | 101,450 |
| Banka e Pare e Investimeve | 2,944,880 |
| Llogari rrjedhese me Banken Amerikane te Investimeve | 463,762 |
| **Totali** | **3,510,092** |

## 8. AKTIVE TE TJERA

Aktivet e tjera më **30 Qershor 2023;** ne zerin "Debitorë të tjerë" janë perfshirë të ardhurat e përllogaritura për tarifën e shoqërisë administruese LEK 814,623:

| | 30 Qershor 2023 |
|---|---:|
| Shpenzime të parapaguara | - |
| Debitorë të tjerë | 814,623 |
| | **814,623** |

## 9. KAPITALI AKSIONAR

Kapitali aksionar i autorizuar, i emetuar dhe i paguar plotësisht i Shoqërisë më **30 Qershor 2023** është si vijon:

| Më 30 Qershor 2023 | Monedha | Nr i aksioneve | Vlera Nominale | Në monedhë origjinale | Në Lek |
|---|---:|---:|---:|---:|---:|
| | LEK | 45,000 | 1,000 | 45,000,000 | 45,000,000 |
| | | **45,000** | | | **45,000,000** |

## 10. DETYRIME TË TJERA

Detyrimet e tjera më **30 Qershor 2023** perfshijne detyrime afatshkurtra ne vleren LEK 591,170 tarife per auditoret, LEK 22,287 TVSH e pagueshme dhe LEK 97,132 (detyrime per sigurime shoqerore + shendetesore dhe TAP);

| | 30 Qershor 2023 |
|---|---:|
| Detyrime te perllogaritura | 591,170 |
| Sigurime shoqërore dhe shpenzime pagash për t'u paguar | 97,132 |
| Tvsh e pagueshme | 22,287 |
| Shpenzime. per taksa te tjera | - |
| | **710,589** |

### 11. SHPENZIMET E PERSONELIT

Shpenzimet e personelit per periudhen e mbyllur me **30 Qershor 2023** paraqiten si me poshte:

| | 30 Qeshor 2023 |
|---|---|
| Paga dhe bonuse | 3,339,564 |
| Sigurimet Shoqërore | 380,931 |
| **Totali** | **3,720,495** |

### 12. SHPENZIME ADMINISTRATIVE

Shpenzimet administrative per periudhen e mbyllur me **30 Qershor 2023** paraqiten si me poshte:

| | 30 Qershor 2023 |
|---|---|
| Konsulencë, sherbime teknike, tarifa regjistrimi dhe komisione | 491,544 |
| Marketing | - |
| Taksa lokale | 74,500 |
| Mirembajtje | 973,765 |
| Penalitet | 10,000 |
| Kancelari | - |
| Internet, komunikim | - |
| Sigurime | - |
| Te tjera | 2,418 |
| **Totali** | **1,552,227** |

### 13. SHPENZIME FINANCIARE

Shpenzime nga interesat sipas kategorive përbëhen nga:

| *Shpenzime financiare* | 30 Qeshor 2023 |
|---|---|
| Shpenzime neto nga interesi për investimet në ATGJ | 11,872 |
| **Totali** | **11,872** |